

2026 qershor

Të dashura familje të Shkollave Publike të NYC,

Ndërsa po përmbyllim vitin shkollor 2025–26 dhe festojmë gjithçka që nxënësit, familjet dhe stafi ynë kanë arritur së bashku, dua t'ju falënderoj *ju* për partneritetin, sinqeritetin dhe përkushtimin tuaj. Është nder për mua t'ju shërbej si Kancelare dhe kam mësuar shumë nga ju gjatë këtyre muajve të fundit.

Që kur mora këtë detyrë në janar, dëgjimi i komunitetit tonë ka qenë një nga përparësitë e mia kryesore. Gjatë 10 Bisedave të Thelluara me Komunitetin në pesë bashkitë e qytetit dhe vizitave në shkolla në të gjitha 45 distriktet e mbikëqyrësve shkollorë, pashë krenarinë e madhe që familjet, nxënësit dhe anëtarët e stafit kanë për komunitetet e tyre shkollorë. Gjithashtu dëgjova mendime të vlefshme për atë që po funksionon mirë dhe për fushat ku mund të vazhdojmë të përmirësohemi. Diskutuam rëndësinë e garantimit të sigurisë dhe përfshirjes së nxënësve, ruajtjes së një arsimi rigoroz dhe tërheqës, avancimit të integritetit të vërtetë në të gjithë sistemin tonë dhe thellimit të angazhimit të familjeve.

Këta zëra — zërat tuaj — po formësojnë rrugën tonë përpara. Kam kënaqësinë të ndaj me ju **Raportin e Turit të Angazhimit** ([schools.nyc.gov/ChancellorEngagementTour](https://schools.nyc.gov/ChancellorEngagementTour)), i cili përfshin atë që dëgjuam nga komunitetet tona dhe mënyrën se si këto ide po udhëheqin hapat tanë të ardhshëm për NYCPS. Tashmë kemi filluar të shndërrojmë në veprim atë që dëgjuam: duke nisur programin 2-K, duke zgjeruar 3-K, duke zhvilluar NYC Reads dhe NYC Solves, duke krijuar grupe pune nëpër distrikte për t'i bërë shkollat tona më të forta dhe shumë nisma të tjera.

Ju falënderoj që keni zgjedhur NYCPS dhe për besimin që vendosni tek ne çdo ditë. Shpresoj që kjo verë t'i sjellë familjes suaj kohë për të pushuar, reflektuar, rifituar energjitë, festuar dhe vazhduar të mësojë. Pres me padurim të vazhdojmë punën tonë në vitin e ardhshëm shkollor, ashtu siç bëmë këtë vit — së bashku. Në bashkëpunim,



Kamar H. Samuels  
Kancelare (Chancellor)